



# AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

## Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.96  
Datë 30.11.2023

**Agjencia e Prokurimit Publik**  
**Blv "Dëshmorët e Kombit"**  
**Tel: + 355 4 2277510**  
**e-mail: [info.app@app.gov.al](mailto:info.app@app.gov.al)**  
**<https://www.app.gov.al>**



## **UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 57 dhe 66; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", nenet 47, 52, 54, shpall konkursin për personel akademik dhe ndihmës akademik, si më poshtë:

1. 1(një) personel akademik me angazhim me kohë të plotë dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, pranë njësisë bazë të Gjuhë Shqipe.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510

<https://www.app.gov.al> 611/632

**Buletini Nr. 96 datë 30 Nëntor 2023**

**Agjencia e Prokurimit Publik**

- të kenë përfunduar studimet e larta në fushën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, në sistemin me kohë të plotë;
  - të kenë notë mesatare të përgjithshme jo më pak se 8(tetë);
  - të kenë përfunduar studimet doktorale/Master i shkencave në fushën e gjuhësisë;
  - të kenë njohuri të mira në një gjuhë perëndimore, preferohet gjuha angleze;
  - të kenë aktivitet botues në revista shkencore të njohura zyrtarisht ose materiale shkencore në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - të kenë aftësi të mira komunikuese të punës në grup;
  - preferohet kandidaët që kanë gradë shkencore apo tituj akademikë.
2. 9 (nëntë) personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, pranë njësisë bazë të Infermierisë.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- të kenë përfunduar studimet në sistemin me kohë të plotë dhe të jenë diplomuar së paku në fushën e mjekësisë së përgjithshme apo të kenë fituar diplomat bachelor dhe master shkencave/diplomë të integruar të nivelit të dytë apo master ekzekutiv në infermieri, infermieri mami, mami;
- në rast se i interesuari zotëron një diplomë të marrë në universitete të huaja, kërkohet që të jetë e ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- duhet të kenë notë mesatare jo më të vogël se 8 (tetë);
- të jenë njohës të një gjuhë të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me përjashtim të atyre që kanë përfunduar në njërin prej cikleve të studimit në njërin nga këto gjuhë;
- të kenë eksperiencë në mësimdhënie univeristare;
- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- të kenë aktivitet botues dhe referues, në revista shkencore ose konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të njohura zyrtarisht;
- preferohen kandidatët me titull akademik, me gradën PhD/"Doktor" apo kanë përfunduar specializimet afatgjata.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës dhe të listës së notave përkatëse (të notuara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);
7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga institucioni ku ka punuar që nuk është marrë ndaj tyre masa disiplinore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera në jetëshkrim;
10. Dëshmi penaliteti.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510

<https://www.app.gov.al> 612/632

**Buletini Nr. 96 datë 30 Nëntor 2023**

**Agjencia e Prokurimit Publik**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nga komisioni ad-hoc nëpërmjet konkurimit me dosje. Konkursi zhvillohet pranë Universitetit "Eqrem Çabej". Dokumentat, të noterizuara brenda tre muajve të fundit, dorëzohen pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative në Universitetin "Eqrem Çabej".

Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 10 ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.